VENDIM
Nr. 309, datë 30.11.2022

MBI ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S NË LIDHJE ME KËRKESËN E SHOQËRISË "BIGWIND" SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw, ME VENDNDODHJE QARKU FIER

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 14, pika 3 të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.11.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1999/5 prot., datë 24.11.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi licencimin e shoqërisë 'Bigwind' sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në fshatin Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, për një afat 25-vjeçar",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 277, datë 27.10.2022 vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Bigwind" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në fshatin Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, për një afat 25-vjeçar.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 28.10.2022 dhe 29.10.2022), si dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s, dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 6.11.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Me shkresën nr. 1815/1 prot., datë 3.11.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht. Në vijim, shoqëria ka kthyer përgjigje me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1815/2 prot., datë 14.11.2022, duke depozituar dokumentacionin plotësues të aplikimit.

- ERE i është drejtuar shoqërisë sërish me shkresën nr. 1815/3 prot., datë 18.11.2022, për plotësimin e një pjese të dokumentacionit të paplotësuar. Në përgjigje, shoqëria ka përcjellë dokumentacion me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1815/4 prot., datë 18.11.2022 dhe ka depozituar dokumentacion plotësues.

- Nga dokumentacioni i depozituar nga shoqëria, rezulton se ka ndryshuar mënyra e financimit të projektit, referuar parashikimeve të vetë shoqërisë në planin e biznesit, ndaj shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin përkatës mbi mbështetjen financiare.

- Në nenin 14, pika 3, të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", e ndryshuar, është parashikuar dhe zgjatja e afatit për pranimin ose refuzimin për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për aplikuesin rasti pas rasti, dhe konkretisht:

3. Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit të përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë së 30 ditë.

- Sa më sipër vlerësohet të zgjatet me 20 (njëzet) ditë vendimmarrja e Bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e shoqërisë "Bigwind" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike. Brenda 10 (dhjetë) ditëve, shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës

që vërteton mbështetjen financiare për realizimin e projektit fotovoltaik, referuar parashikimeve të planit të biznesit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 20 ditë vendimmarrjen e Bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e shoqërisë "Bigwind" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje qarku Fier.

2. Brenda 10 ditëve, shoqëria "Bigwind" sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin që vërteton mbështetjen financiare për realizimin e projektit fotovoltaik, referuar parashikimeve të planit të biznesit.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti